



RAPORTI VJETOR

2010-2011

Tiranë, korrik 2011

RAPORTI VJETOR PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011

Pasqyra e lëndës:

| | |
|--|----|
| 1. Realizimi i misionit të arsimit të lartë | 2 |
| 2. Realizimi vjetor i objektivave të institucionit | 3 |
| 3. Të dhëna të përgjithshme mbi institucionin | 5 |
| 4. Relacion në lidhje me plotësimin e standardeve shtetërore | 34 |
| 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve | 55 |
| 6. Fushata e marketingut..... | 56 |
| 7. Vlerësime të institucionit mbi MASH dhe rekomandime | 56 |

Tiranë, korrik 2011

1. Realizimi i misionit të arsimit të lartë

Misioni i Universitetit “Epoka”, i cili nisi veprimtarinë në vitin akademik 2007-2008, konsiston në të qenit një institucion mësimor-kërkimor inovativ dhe me influencë, në shërbim të vlerave humane thelbësore nëpërmjet prodhimit, shpërndarjes dhe zhvillimit të dijeve në nivel ndërkombëtar; rritja e individëve me ndjeshmëri sociale, të mirëkualifikuar, produktivë, profesionalë dhe të përgjegjshëm, me shpirt të orientuar drejt kërkimit dhe të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare; si dhe dhënia e kontributit në kuadër të përmirësimit të cilësisë së jetës së shoqërisë bazuar në nevojat rajonale dhe botërore.

Misioni i sipërpërmendur është konceptuar në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, të shprehur në nenin 2 të Ligjit “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me standardet ndërkombëtare si dhe me veçantitë dhe risitë që synon të sjellë ky institucion në vendin tonë dhe më gjerë.

Në funksion të realizimit të këtij misioni dhe të rolit që institucionet e arsimit të lartë në tërësinë e tyre duhet të luajnë në dobi të shoqërisë ku zhvillojnë aktivitetin e tyre, Universiteti “Epoka”, gjatë vitit akademik 2010-2011, kreu aktivitete të shumëllojshme në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe kontributit për shoqërinë.

Universiteti zhvilloi aktivitetin e tij të mësimdhënies cilësore në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë (MND) të studimeve në dy Fakultete: Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë si dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative përkatësisht në këto fusha: Arkitekturë, Inxhinieri Ndërtimi, Inxhinieri Kompjuterike, Ekonomiks, Financë-Bankë, Administrim Biznesi, Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare si dhe Studime Europiane. Në këtë kuadër, në përfundim të këtij viti akademik, u diplomua edhe brezi i parë i studentëve në programe të studimit të tre cikleve të ofruara nga ana e Universitetit.

Tregues i cilësisë së mësimdhënies në Universitetin “Epoka” ishte edhe akreditimi institucional dhe i programeve të studimit “Bachelor” nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në muajin qershor 2011 si dhe klasifikimi i Universitetit në grupin e universiteteve më të mira në vend, veçanërisht në fushën e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në kuadër të projektit pilot për renditjen e Universiteteve, të kryer nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), në bashkëpunim me kompaninë gjermane CHE.

Gjatë vitit akademik 2010-2011, u publikuan në total 97 artikuj dhe 8 libra si dhe u realizuan katër konferenca ndërkombëtare.

Në kuadër të mësimin gjatë gjithë jetës dhe të kontributit për shoqërinë u realizuan kurse trajnimi për punonjësit e kompanive private, kurse trajnimi për mësuesit e shkollave të mesme në të gjithë Shqipërinë, këshillim karriere për maturantët e shkollavë të mesme në të gjithë vendin, seminare etj..

Në kuadër të kontributit që çdo Universitet duhet të japë për zhvillimin e vendit, u zhvilluan me sukses 14 programe Master ku rreth 200 studentë paraqitën tezat e tyre mbi një gamë të gjerë sektorësh dhe çështjesh të ndryshme që prekin Shqipërinë, duke dhënë në këtë mënyrë një kontribut të rëndësishëm në fondin e literaturës që ekziston rreth tregut shqiptar.

Në të njëjtën kohë, konferencat ndërkombëtare të organizuara nga ana e Universitetit “Epoka” mblodhën akademikë nga e gjithë bota, për të diskutuar rreth temave të cilat shqetësojnë sot rajonin dhe në veçanti Shqipërinë, duke përbërë një bazë të mirë për rekomandime për politikëbërësit.

Njëkohësisht, në kuadër të promovimit të kulturës shqiptare si dhe të inkurajimit të investimeve të huaja në vend, mbi 2000 akademikë, biznesmenë si dhe përfaqësues shteti vizituan Universitetin “Epoka” dhe qytetet kryesore të Shqipërisë me ftesë të këtij të fundit, me qëllim shqyrtimin e mundësive të bashkëpunimit dhe të investimit.

Gjatë vitit akademik 2010-2011, Universiteti “Epoka” vijoi t’i kushtonte një rëndësi të veçantë aktiviteteve jashtë-kurrikulare të studentëve, nëpërmjet aktivizimit të tyre në aktivitete sociale, kulturore dhe sportive nëpërmjet klubeve studentore, organizimit të praktikave të punës në institucione publike dhe kompani private brenda dhe jashtë vendit, planifikimit të karrierës etj..

2. Realizimi vjetor i objektivave të institucionit

Gjatë vitit akademik 2010-2011, Universiteti “Epoka” përmbushi synimet e planifikuara në lidhje me procesin e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe kontributit ndaj shoqërisë.

Në lidhje me procesin mësimdhënës, një vëmendje e veçantë iu kushtua përqendrimit të mësimdhënies tek rezultatet e nxënies (learning outcomes) si dhe matjes të këtyre rezultateve. Në fund të çdo semestri, pedagogët iu nënshtruan vlerësimit nga ana e studentëve në lidhje me të gjithë parametrat e procesit të mësimdhënies dhe rezultatet e këtij vlerësimi u përdorën nga ana e autoriteteve drejtuese për të planifikuar stafin akademik për semestrin pasardhës si dhe nga ana e pedagogëve për të përmirësuar ato pika të theksuara nga ana e studentëve. Viti akademik 2010-2011 filloi në mesin e re në kampusin universitar në Rinas, e cila përmban të gjithë infrastrukturën e nevojshme fizike dhe teknologjike për një zhvillim të procesit mësimor në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare, duke mundur veçanërisht mbështetjen e vazhdueshme të procesit mësimdhënies në përdorimin e teknologjisë së informacionit. Në të njëjtën kohë, ndryshimet e nevojshme u kryen në të gjitha programet e studimit me qëllim pasqyrimin e ndryshimeve në ligjin “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Cilësia e mësimdhënies u konfirmua edhe nga akreditimi institucional dhe ai i programeve Bachelor në muajin qershor 2011 nga ana e Agjencisë Publike për Akreditimin e Arsimit të Lartë (APAAL) sidhe nga klasifikimi i Universitetit “Epoka” si një nga universitetet më të mira në kuadër të projektit pilot të renditjes të kryer nga MASH dhe APAAL në bashkëpunim me kompaninë gjermane CHE.

Për sa i përket procesit të kërkimit shkencor, Universiteti “Epoka” vijoi të mbështeste financiarisht publikimin e librave dhe artikujve shkencorë si dhe pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca dhe aktivitete të tjera shkencore brenda dhe jashtë vendit. Në këtë kuadër, gjatë vitit akademik 2010-2011, u publikuan në total 97 artikuj dhe 8 libra si dhe u organizuan katër konferenca ndërkombëtare nga ana e Universitetit. Në të njëjtën kohë, stafi i Universitetit mori pjesë në 15 konferenca shkencore, të organizuara kryesisht jashtë vendit.

Gjatë vitit akademik 2010-2011, vëmendje e veçantë iu kushtua edhe dimensionit të kontributit ndaj shoqërisë, i cili u realizua nëpërmjet organizimit të trajnimeve në kuadër të të mësuarit gjatë gjithë jetës, organizimit të seminareve trajnuese për stafin e Drejtorive Arsimore Rajonale dhe të stafit pedagogjik të shkollave të mesme të këtyre Drejtorive, organizimin e vizitave dhe të takimeve nga ana e maturantëve në kuadër të planifikimit të karrierës, përfshirjes aktive të studentëve në aktivitete sociale.


Për sa i përket zbatimit të masave të parashikuara në planin strategjik afatshkurtër, gjatë vitit akademik 2010-2011, u sigurua realizimi i masave të mëposhtme:

- akreditimi institucional dhe ai i programeve të studimit Bachelor nga ana e APAAL-it;
- përshtatja e të gjithë programeve të studimit në përputhje me ndryshimet në ligjin “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- mbështetja e procesit mësimdhënës në rezultatet e nxënies;
- përfundimi i godinës së parë në kampusin e ri të Universitetit në Rinas;
- fillimi i punimeve në godinat e tjera në kampusin e ri të Universitetit në Rinas;
- rritja e përdorimit të teknologjisë së informacionit nga ana e stafit dhe studentëve;
- përmirësimi i përdorimit të sistemit të automatizimit dhe më konkretisht i sistemit të automatizimit për stafin dhe studentët;
- ngritja e Sistemit të Informacionit mbi Procesin e Mësimdhënies (EIS);
- përthithja e stafit akademik me përvojë dhe me tituj akademikë, duke mundësuar mbulimin e pjesës më të madhe të mësimdhënies nga stafi me kohë të plotë;
- shtimi i numrit të konferencave dhe aktiviteteve shkencore të organizuara nga ana e Universitetit;
- shtimi cilësor dhe sasior i publikimeve shkencore të stafit të Universitetit;
- përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së studentëve të pranuar në Universitet;
- rritja e bashkëpunimit me universitetet dhe institucionet kërkimore-shkencore, brenda dhe jashtë vendit;
- rritja e kapaciteteve të bibliotekës;
- përmirësimi i shërbimit të ushqimit, akomodimit dhe çlodhjes për studentët;
- shtimi i aktiviteteve social-kulturore për studentët.

Gjatë vitit akademik 2010-2011, nuk u arrit të përmbushej masa mbi përfitimin nga programet kërkimore të financuara nga ana e BE-së si FP7 dhe Jean Monnet duke qenë se aplikimet e dërguara nga ana e Universitetit nuk e kaluan fazën e kualifikimit final. Në këtë kuadër, stafi akademik i Universitetit ka përfituar asistencë teknike nga ana e stafit të Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) në lidhje me hartimin e projekt-propozimeve dhe planifikohet që në vitin akademik 2011-2012, Universiteti të mund të përfitojë nga programet kërkimore të BE-së.

3. Të dhëna të përgjithshme mbi institucionin

- *Struktura organizative dhe titullari i institucionit*



Rektori: Prof. Dr. Hasan Kaplan

Kabineti i Rektorit: Z. Niuton Mulleti (Përgjegjës)

Zj. Alba Gërdeci

- *Organet vendimmarrëse si dhe njësitë akademike dhe administrative, shoqëruar me titullarët përkatës*

1. Këshilli i Lartë

| Emër Mbiemër | Detyra |
|---------------------|---------------|
| Sadık Kesmeci | Kryetar |
| Süleyman Gülez | Zv. Kryetar |
| Mustafa Özcan | Anëtar |
| İsmet Aksoy | Anëtar |
| Asım Demiröz | Anëtar |
| Cemil Koca | Anëtar |
| Hasan Kaplan | Anëtar |
| Hamza Tok | Raportues |

2. Senati Akademik

- Prof. Dr. Hasan Kaplan (Kryetar)
- Prof. Dr. Ömer Eroğlu
- Assoc. Prof. Dr. Ahmet Öztaş
- Prof. Dr. Güngör Turan
- Assist. Prof. Dr. Hüseyin Bilgin
- Z. Hamza Tok (Raportues)

3. Bordi Administrativ i Universitetit

- Prof. Dr. Hasan Kaplan (Kryetar)
- Prof. Dr. Ömer Eroğlu
- Assoc. Prof. Dr. Ahmet Öztaş

- Prof. Dr. Güngör Turan
- Assist. Prof. Dr. Hüseyin Bilgin
- Assist. Prof. Dr. Yavuz Yardım
- Z. Hamza Tok (Raportues)

4. Bordi i Vlerësimit Akademik dhe Përmirësimit të Cilësisë

- Prof. Dr. Hasan Kaplan
- Prof. Dr. Ömer Eroğlu
- Assoc. Prof. Dr. Ahmet Öztaş
- Assoc. Prof. Dr. Cüneyt Yenigün
- Z. Hamza Tok
- Zj. Manjola Hoxha (Cenolli)
- Z. Nertil Mera

5. Grupi Kordinator i Programeve Master

- Assist. Prof. Dr. Yavuz Yardım
- Z. Klodian Shaqiri

6. Bordi i Menaxhimit të Cilësisë

- Z. Nihat Cengiz (Kryetar)
- Zj. Manjola Hoxha (Cenolli)
- Z. Skënder Bruçaj
- Z. Igli Hakrama
- Z. Albi Koçibelli

7. Bordi i Etikës

- Assoc. Prof. Dr. Ahmet Öztaş (Kryetar)
- Assist. Prof. Dr. Mustafa Üç
- Z. Mustafa Erdem

- Z. Niuton Mulleti

8. Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare

- Assoc. Prof. Dr. Ahmet Öztaş – Drejtor
- Zj. Irena Semanaj

9. Zv. Rektor - Prof. Dr. Omer Eroglu

10. Zv. Rektor - vakant

11. Sekretari i Përgjithshëm – Z. Hamza Tok

- Zyra e Financës – Z. Halil Buzkan
- Zyra Ligjore – Zj. Alba Gërdeci
- Zyra e Marrëdhënieve me Median dhe Publikun – Z. Xhafer Rakiplari
- Zyra e Çështjeve Administrative – Z. Şahin Çakar
- Zyra e Burimeve Njerëzore – Z. Albi Kocibelli
- Zyra e Çështjeve Administrative dhe Teknike – Z. Rudin Qordja

12. Dekani i Studentëve – Z. Mustafa Erdem

- Zyra e Aktiviteteve Studentore – Z. Skënder Bruçaj
- Zyra Mësimore – Zj. Manjola Hoxha (Cenolli)
- Zyra e Përzgjedhjes dhe Pranimit të Studentëve – Z. Armando Demaj

13. Zyra Koordinuese e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit – Z. Ahmed Fatih Ersoy

- Zyra e Sistemit të Informacionit
- Biblioteka
- Zyra e Materialeve Mësimore
- Zyra e Publikimeve

14. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë

Dekani: Assoc. Prof. Dr. Ahmet Öztaş

- Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike;
Përgjegjës i Departamentit: Assist. Prof. Dr. Özcan Asilkan
- Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit;
Përgjegjës i Departamentit: Assist. Prof. Dr. Yavuz Yardım
- Departamenti i Arkitekturës;
Përgjegjës i Departamentit: Assist. Prof. Dr. Sokol Dervishi

15. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative

Dekani: Prof. Dr. Güngör Turan

- Departamenti i Ekonomiksit;
Përgjegjës i Departamentit: vakant
- Departamenti i Financë-Bankës;
Përgjegjës i Departamentit: Prof. Dr. Güngör Turan
- Departamenti i Administrim Biznesit;
Përgjegjës i Departamentit: Assist. Prof. Dr. Mustafa Üç
- Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
- Përgjegjës i Departamentit: Assist. Prof. Dr. Salih Özcan

16. Qendrat kërkimore

- Qendra për Studime Europiane – vakant
- Qendra e Studimeve Gjatë Gjithë Jetës dhe Planifikimit të Karrierës – Z. Ramadan Çipuri
- Qendra për Tërmetet dhe Teknologjitë e Ndërtimit – Assist. Prof. Dr. Hüseyin Bilgin
- Qendra Kërkimore dhe e Aplikimit në fushën e Manaxhimit të Cilësisë – Prof. Dr. Hasan Kaplan

Programet e studimit të ofruara nga ana e Universitetit si dhe programet e studimit në proces licencimi

Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 281, datë 12.03.2008 “Për Liçensimin e Institucionit të Arsimit të Lartë Privat “Epoka”, janë hapur këto programe studimi të ciklit të parë në formën e studimeve me kohë të plotë në:

- i. Arkitekturë
- ii. Inxhinieri Ndërtimi
- iii. Inxhinieri Kompjuterike
- iv. Ekonomiks
- v. Financë-Bankë
- vi. Administrim Biznesi
- vii. Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare

Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 908, datë 26.08.2009, si dhe Nr. 90, datë 10.02.2010 “Për hapjen e programeve të reja të studimit në Institucionin Privat të Arsimit të Lartë “Epoka”, janë hapur këto programe studimi të ciklit të dytë dhe të tretë:

Cikli i dytë:

- i. DND në Arkitekturë
- ii. DND në Inxhinieri Kompjuterike
- iii. DND në Financë-Bankë
- iv. DND në Administrim Biznesi
- v. DND në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare
- vi. DND në Inxhinieri Ndërtimi Profilet: Manaxhim i Ndërtimeve dhe Inxhinieri e Ndërtimeve

Cikli i tretë:

- i. MND në Arkitekturë
- ii. MND në Inxhinieri Kompjuterike
- iii. MND në Financë-Bankë
- iv. MND në Administrim Biznesi
- v. MND në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare
- vi. MND në Studime Europiane
- vii. MND në Inxhinier Ndërtimi

Në të njëjtën kohë, në përputhje me dispozitat e Ligjit “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në vijim të korrespondencës me MASH-in, Programet MND që ofronte Universiteti janë transformuar në Programe Master Profesional. Në të njëjtën kohë, duke filluar nga viti akademik 2011-2012, Programi i Studimeve Financë-Bankë do të ofrohet edhe në gjuhën shqipe.

Njëkohësisht, në përputhje me dispozitat e Ligjit “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është paraqitur në MASH kërkesa për ristrukturimin e Programeve të Studimit të Ciklit të Parë dhe të Dytë në Arkitekturë në Program Studimi të Integruar të Ciklit të Dytë në Arkitekturë.

Programe në proces të licensimit - Data e paraqitjes së aplikimit në MASH: 8 prill 2011

- i. Master i Arteve të Bukura në Ekonomiks
- ii. Bachelor në Informatikë-Ekonomike

• ***Të dhëna të përgjithshme numerike mbi Institucionin:***

1. Nivelet dhe programet e studimit që ofron institucioni;

a) Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë ofron:

Programet e studimit të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë në përfundim të të cilave lëshohet Diplomë Bachelor:

- i. Arkitekturë (4 vite akademike);
- ii. Inxhinieri ndërtimi (4 vite akademike);
- iii. Inxhinieri kompjuterike (4 vite akademike)

Programet e studimit të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë në përfundim të të cilave lëshohet Diplomë Master Shkencor:

- i. Master Shkencor në Arkitekturë (2 vite akademike)
- ii. Master Shkencor në Inxhinieri Kompjuterike (2 vite akademike)
- iii. Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi (Profillet: Menaxhim i Ndërtimeve dhe Inxhinieri e Strukturave) (2 vite akademike)

Programet e studimit të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë në përfundim të të cilave lëshohet diplomë Master Profesional:

- i. Master Profesional në Arkitekturë (1 vit akademik)
- ii. Master Profesional në Inxhinieri Kompjuterike (1 vit akademik)

- iii. Master Profesional në Inxhinieri Ndërtimit (1 vit akademik)

b) Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative ofron:

Programet e studimit të ciklit të parë në formën e studimeve me kohë të plotë, në përfundim të të cilave lëshohet Diplomë Bachelor:

- i. Ekonomiks (4 vite akademike)
- ii. Financë-Bankë (4 vite akademike);
- iii. Financë-Bankë në gjuhën shqipe (4 vite akademike);
- iii. Administrim Biznesi (4 vite akademike);
- iv. Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare (4 vite akademike).

Programet e studimit të ciklit të dytë në formën e studimeve me kohë të plotë në përfundim të të cilave lëshohet Diplomë Master i Arteve të Bukura:

- i. Master i Arteve të Bukura në Financë-Bankë (2 vite akademike);
- ii. Master i Arteve të Bukura në Administrim Biznesi (2 vite akademike);
- iii. Master i Arteve të Bukura në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare (2 vite akademike);

Programet e studimit të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë në përfundim të të cilave lëshohet diplomë Master Profesional:

- i. Master Profesional në Financë-Bankë (1 vit akademik);
- ii. Master Profesional në Administrim Biznesi (1.5 vite akademike);
- iii. Master Profesional në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare (1 vit akademik);
- iv. Master Profesional në Studime Europiane (1 vit akademik)

2. Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar sipas niveleve dhe programeve të studimit;

| Fakulteti / Emërtimi i Programit të Studimit | CIKLI I PARË | CIKLI I DYTË | CIKLI I TRETË | TOTALI |
|--|--------------|--------------|---------------|------------|
| FAKULTETI I ARKITEKTURES DHE INXHINIERISE | 242 | 27 | 53 | 322 |
| BA-ARKITEKTURE | 92 | - | - | 92 |
| BA-INXHINIERI NDËRTIM | 63 | - | - | 63 |
| BA-INXHINIERI KOMPJUTERIKE | 87 | - | - | 87 |

| | | | | |
|---|------------|-----------|------------|------------|
| MSc- INXHINIERI KOMPJUTERIKE | - | 27 | - | 27 |
| MND- ARKITEKTURE | - | - | 11 | 11 |
| MND-INXHINIERI NDËRTIMI | - | - | 20 | 20 |
| MND- INXHINIERI KOMPJUTERIKE | - | - | 22 | 22 |
| FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE DHE ADMINISTRATIVE | 233 | 11 | 120 | 364 |
| BA-BANKË FINANCË | 96 | - | - | 96 |
| BA-ADMINISTRIM BIZNES | 54 | - | - | 54 |
| BA-EKONOMIKS | 14 | - | - | 14 |
| BA-SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE NDERKOMBETARE | 69 | - | - | 69 |
| MA- SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE NDERKOMBËTARE | - | 11 | - | 11 |
| MND - BANKË FINANCË | - | - | 22 | 22 |
| MND- ADMINISTRIM BIZNES | - | - | 80 | 80 |
| MND- STUDIME EUROPIANE | - | - | 5 | 5 |
| MND-SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE NDERKOMBËTARE | - | - | 13 | 13 |
| TOTALI | 475 | 38 | 173 | 686 |

3. Numri i të diplomuarve sipas niveleve dhe programit të studimit;

| Fakulteti / Emërtimi i Programit të Studimit | CIKLI PARË | CIKLI DYTË | CIKLI TRETË | TOTALI |
|---|-------------------|-------------------|--------------------|---------------|
| FAKULTETI I ARKITEKTURES DHE INXHINIERISE | 10 | 0 | 10 | 20 |
| BA-INXHINIERI NDERTIM | 10 | - | - | 10 |
| MND-INXHINIERI NDERTIMI | - | - | 2 | 2 |
| MND- INXHINIERI KOMPJUTERIKE | - | - | 8 | 8 |
| FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE DHE ADMINISTRATIVE | 20 | 1 | 39 | 60 |

| | | | | |
|--|-----------|----------|-----------|-----------|
| BA-BANKE FINANCE | 11 | - | - | 11 |
| BA-ADMINISTRIM BIZNES | 9 | - | - | 9 |
| MA- SHKENCA POLITIKE DHE MARREDHENIE NDERKOMBETARE | - | 1 | - | 1 |
| MND- ADMINISTRIM BIZNES | - | - | 36 | 36 |
| MND- STUDIME EUROPIANE | - | - | 2 | 2 |
| MND-SHKENCA POLITIKE DHE MARREDHENIE NDERKOMBETARE | - | - | 1 | 1 |
| TOTALI | 30 | 1 | 49 | 80 |

4. Numri i studentëve të transferuar (shoqëruar me informacion mbi institucionin e parë, programin e studimit dhe semestrin ku transferohet);

| Nr. | PROGRAMI I STUDIMIT | SEMESTRI KU TRANSFEROHET | INSTITUCIONI I PARË |
|-----|----------------------------|--------------------------|---|
| 1 | BA-ADMINISTRIM BIZNES | SEMESTRI 5. | UNIVERSITETI UFO , DEGA EKONOMIKS |
| 2 | BA-ADMINISTRIM BIZNES | SEMESTRI 4. | BOROUGH MANHATTAN COLLEGE, DEGA ADMINISTRIM BIZNESI |
| 3 | BA-ARKITEKTURE | SEMESTRI 1. | UNIVERISTETI SHTETËROR I TETOVES, DEGA ARKITEKTURE |
| 4 | BA-ARKITEKTURE | SEMESTRI 5. | UNIVERSITETI POLIS, DEGA ARKITEKTURE |
| 5 | BA-ARKITEKTURE | SEMESTRI 5. | UNIVERSITETI MIMAR SINAN, DEGA ARKITEKTURE |
| 6 | BA-INXHINIERI KOMPJUTERIKE | SEMESTRI 1. | UNIVERSITETI I TIRANËS, DEGA INFORMATIKE |
| 7 | BA-INXHINIERI KOMPJUTERIKE | SEMESTRI 5. | UNIVERSITET POLITEKNIK I TIRANËS |
| 8 | BA-INXHINIERI KOMPJUTERIKE | SEMESTRI 5. | UNIVERSITETI I TIRANËS,FAKULTETI I SHKENCAVE NATYRORE |
| 9 | BA-INXHINIERI KOMPJUTERIKE | SEMESTRI 3. | UNIVERSITETI BOĞAZIÇI, DEGA INXHINIERI KOMPJUTERIKE |

| | | | |
|----|---|-------------|---|
| 10 | BA-INXHINIERI KOMPJUTERIKE | SEMESTRI 1. | IZMIR HIGH TECHONOLGY INSTITUTE, DEGA INXHINIERI ELEKTRONIKE |
| 11 | BA-INXHINIERI KOMPJUTERIKE | SEMESTRI 3. | UNIVERSITETI FATIH, DEGA INXHINIERI ELEKTRONIKE |
| 12 | BA-INXHINIERI KOMPJUTERIKE | SEMESTRI 3. | UNIVERSITET POLITEKNIK I TIRANËS, DEGA INXHINIERI ELEKTRONIKE |
| 13 | BA-INXHINIERI KOMPJUTERIKE | SEMESTRI 3. | UNIVERSITET POLITEKNIK I TIRANËS, DEGA INXHINIERI ELEKTRONIKE |
| 14 | BA-INXHINIERI NDËRTIM | SEMESTRI 7. | BUDAPEST UNIVERSITY OF TECHNOLOGY, DEGA INXHINIERI NDËRTIMI |
| 15 | BA-INXHINIERI NDËRTIM | SEMESTRI 3. | UNIVERSITET POLITEKNIK I TIRANËS,DEGA INXHINIERI NDËRTIMI |
| 16 | BA-INXHINIERI NDËRTIM | SEMESTRI 5. | UNIVERSITETI FIRAT, DEGA E SHKENCAVE TEKNIKE |
| 17 | BA-INXHINIERI NDËRTIM | SEMESTRI 3. | UNIVERSITET POLITEKNIK I TIRANËS, DEGA INXHINIERI NDËRTIMI |
| 18 | BA-INXHINIERI NDËRTIM | SEMESTRI 5. | UNIVERSITETI FIRAT,FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE |
| 19 | BA-INXHINIERI NDËRTIM | SEMESTRI 6. | MIDDLE EAST TECHNICAL UNIVERSITY, DEGA INXHINIERI NDËRTIMI |
| 20 | BA-INXHINIERI NDËRTIM | SEMESTRI 4. | UNIVERSITETI TIRANËS, DEGA MATEMATIKE |
| 21 | BA-INXHINIERI NDËRTIM | SEMESTRI 4. | MIDDLE EAST TECHNICAL UNIVERSITY, DEGA INXHINIERI NDËRTIMI |
| 22 | BA-INXHINIERI NDËRTIM | SEMESTRI 4. | UNIVERSITETI SAKARYA, DEGA INXHINIERI NDËRTIMI |
| 23 | BANKING AND FINANCE | SEMESTRI 3. | UNIVERSITETI TIRANËS, DEGA EKONOMIKS |
| 24 | BA-SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE | SEMESTRI 1. | UNIVERSITETI I TIRANËS,FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE |

| | | | |
|----|---|-------------|---|
| | NDERKOMBETARE | | |
| 25 | BA-SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE NDERKOMBETARE | SEMESTRI 1. | PAVIA UNIVERSITY, FAKULTETI DREJTËSISE |
| 26 | BA-SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE NDERKOMBETARE | SEMESTRI 1. | UNIVERSITETI LA SAPINZA, DEGA E SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE NDERKOMBËTARE |
| 27 | MND-ADMINISTRIM BIZNES | SEMESTRI 1. | UNIVERSITETI FATIH, MASTER NE DEGËN MENAXHIM |
| 28 | MND-ADMINISTRIM BIZNES | SEMESTRI 1. | BUDAPEST BUSINESS SCHOOL, MASTER NE DEGËN MARKETING NDERKOMBETAR |
| 29 | MND- INXHINIERI KOMPJUTERIKE | SEMESTRI 1. | UNIVERSITETI BOGAZICI, MASTER NE DEGËN INXHINIERI KOMPJUTERIKE |
| 30 | MSc - INXHINIERI KOMPJUTERIKE | SEMESTRI 1. | UNIVERSITET POLITEKNIK I TIRANËS, STUDIME TË CIKLIT TE DYTË NË INXHINIERI INFORMATIKE |

5. Pagesat totale (tarifat e studimit, regjistrimit etj.) për secilin program studimi në bazë të kohëzgjatjes së studimit;

Tarifat e studimit për vitin akademik 2010-2011 ishin si më poshtë vijon:

| Fakulteti | Tarifa e programeve Bachelor | Tarifa e programeve Master Shkencor/Master i Arteve të Bukura | Tarifa e programeve Master i Nivelit të Dytë |
|---|-------------------------------------|--|---|
| Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë | 3.500 Euro për vit akademik | 36 Euro për kredit ECTS | 36 Euro për kredit ECTS |
| Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe | 2.500 Euro për vit akademik | 36 Euro për kredit ECTS | 36 Euro për kredit ECTS |

| | | | |
|----------------|--|--|--|
| Administrative | | | |
|----------------|--|--|--|

6. *Numri i përgjithshëm i personelit akademik (të listuar së bashku me të dhënat mbi numërin e Prof., Dr., etj. dhe raportet studentë/profesorë).*

• **Lista e stafit akademik për semestrin e vjeshtës, viti akademik 2010-2011:**

Departamenti i Arkitekturës

| Emri Mbiemri | Titulli akademik | Punesimi |
|-----------------------|------------------|-----------|
| Ahmet Öztaş | Assoc.Prof. Dr | Full-time |
| Halil Semih Eryıldız | Prof. Dr | Full-time |
| Dorina Pojani | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Sokol Dervishi | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Hakan Arslan | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Edmond Manahasa | M.Arch | Full-time |
| Odeta Manahasa | M.Arch | Full-time |
| Artan Hysa | M.Arch | Full-time |
| Desantila Rrumbullaku | M.Arch | Full-time |
| Valbona Koçi | M.Arch | Full-time |
| Anna Yunitsyna | M.Arch | Full-time |
| Jurtin Hajro | M.Arch | Full-time |
| Ledita Mezini | M.Arch | Part-time |

Departmenti i Inxhinierisë Ndërtimit

| Emri Mbiemri | Titulli akademik | Punesimi |
|--------------------|------------------|-----------|
| Hasan Kaplan | Prof. Dr | Full-time |
| Mehmet Ardiçlıoğlu | Assoc.Prof. Dr | Full-time |
| Hüseyin Bilgin | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Yavuz Yardım | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Erion Luga | M.Sc | Full-time |
| Alban Kuriqi | M.Sc | Full-time |
| Rudin Qordja | M.Sc | Full-time |
| Armando Demaj | M.Sc | Full-time |
| Ylber Muceku | Assist.Prof. Dr | Part-time |
| Ferdinand Berberi | M.Sc | Part-time |
| Erjon Petriti | M.Sc | Part-time |

Departmenti i Inxhinierisë Kompjuterike

| Emri Mbiemri | Titulli akademik | Punesimi |
|-----------------------|------------------|-----------|
| Özcan Asilkan | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Şevket Civelek | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Arban Uka | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Vijaya Raju Mullagiri | Assist.Prof | Full-time |
| Ibrahim Meşecan | M.Sc | Full-time |

| | | |
|--------------------|----------------|-----------|
| Abdurrahman Çelebi | M.Sc | Full-time |
| Ahmed Fatih Ersoy | M.Sc | Full-time |
| Igli Hakrama | M.Sc | Full-time |
| Betim Çiço | Prof. Dr | Part-time |
| Bekim Fetaji | Assoc.Prof. Dr | Part-time |
| Ermir Papadhimitri | M.Sc | Part-time |
| Erind Bedalli | M.Sc | Part-time |

Departmenti i Ekonomiksit

| Emri Mbiemri | Titulli akademik | Punesimi |
|----------------|------------------|-----------|
| Ömer Eroğlu | Prof. Dr | Full-time |
| Cengiz Toraman | Prof. Dr | Full-time |
| Seref Kalayci | Assoc.Prof. Dr | Full-time |
| Nihat Cengiz | M.Sc | Full-time |
| Hamza Tok | M.A | Full-time |
| Matilda Likaj | M.A | Full-time |
| Timothy Hagen | M.A | Full-time |

Departmenti i Financë-Bankës

| Emri Mbiemri | Titulli akademik | Punesimi |
|---------------|------------------|-----------|
| Güngör Turan | Prof. Dr | Full-time |
| Sadik Cökelez | Prof. Dr | Full-time |

| | | |
|-------------------|-----------------|-----------|
| Nedret Demirci | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Eglantina Hysa | M.A | Full-time |
| Ermira Zifla | M.A | Full-time |
| Pranvera Sagajeva | M.A | Full-time |
| Avenir Lleshanaku | M.A | Full-time |
| Jolta Kaçani | M.A | Part-time |
| Sybi Hida | M.A | Part-time |

Departmenti i Administrim Biznesit

| Emri Mbiemri | Titulli akademik | Punesimi |
|---------------------|-------------------------|-----------------|
| Mustafa Üç | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Huseyin Kanibir | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Murat Karagoz | Assoc.Prof. Dr | Full-time |
| Alba Kruja | M.A | Full-time |
| Urmat Ruskylov | M.A | Full-time |
| Alba Gerdeci | M.A | Full-time |
| Gezim Hysenagolli | M.A | Full-time |
| Orhan Coskun | Assist.Prof. Dr | Part-time |
| Orkunt Yozgat | Assist.Prof. Dr | Part-time |
| Clirim Toci | Assist.Prof. Dr | Part-time |
| Mirdaim Axhami | Assist.Prof | Part-time |
| Melih Arat | M.A | Part-time |
| Ergis Ulqinaku | M.A | Part-time |

Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare

| Emri Mbiemri | Titulli akademik | Punesimi |
|------------------|------------------|-----------|
| Cemal Baltacı | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Ferdinand Gjana | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Salih Özcan | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Ramadan Çipuri | M.A | Full-time |
| Niuton Mulleti | M.A | Full-time |
| Albi Kocibelli | M.A | Full-time |
| Xhafer Rakiplari | M.A | Full-time |
| Reina Zenelaj | M.A | Full-time |
| Mustafa Erdem | M.A | Full-time |
| Bekir Çınar | Assist.Prof. Dr | Part-time |
| Bledar Maksuti | Ll.M | Part-time |
| Martin Arslanian | M.A | Full-time |
| Gladiola Pazaçaj | M.A | Full-time |
| Adem Çalışkan | M.A | Part-time |

| Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|------------|-----------------|------------------|--------|----------|-----------|-----------------|------------------|--------|----------|------------------------|-----------------|------------------|--------|----------|
| Departamenti | Full- time | | | | | Part-time | | | | | Gjithsej staf akademik | | | | |
| | Prof. Dr | Assoc. Prof. Dr | Assist. Prof. Dr | Master | Gjithsej | Prof. Dr | Assoc. Prof. Dr | Assist. Prof. Dr | Master | Gjithsej | Prof. Dr | Assoc. Prof. Dr | Assist. Prof. Dr | Master | Gjithsej |
| Arkitekturë | 1 | 1 | 3 | 7 | 12 | - | - | - | 1 | 1 | 1 | 1 | 3 | 8 | 13 |
| Inxhinieri Ndërtimi | 1 | 1 | 2 | 4 | 8 | - | - | 1 | 2 | 3 | 1 | 1 | 3 | 6 | 11 |

| | | | | | | | | | | | | | | | |
|----------------------------|---|---|---|----|----|---|---|---|---|---|---|---|---|----|----|
| Inxhinieri Kompjuterike | - | - | 3 | 5 | 8 | 1 | 1 | - | 2 | 4 | 1 | 1 | 3 | 7 | 12 |
| Gjithsej | 2 | 2 | 8 | 16 | 28 | 1 | 1 | 1 | 5 | 8 | 3 | 3 | 9 | 21 | 36 |

| Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|-------------|-----------------------|------------------------|--------|----------|-------------|-----------------------|------------------------|--------|----------|------------------------|-----------------------|------------------------|--------|----------|
| Departamenti | Full- time | | | | | Part-time | | | | | Gjithsej staf akademik | | | | |
| | Prof. Dr | Assoc. Prof. Dr | Assist. Prof. Dr | Master | Gjithsej | Prof. Dr | Assoc. Prof. Dr | Assist. Prof. Dr | Master | Gjithsej | Prof. Dr | Assoc. Prof. Dr | Assist. Prof. Dr | Master | Gjithsej |
| Ekonomiks | 2 | 1 | - | 4 | 7 | - | - | - | - | - | 2 | 1 | - | 4 | 7 |
| Financë-Bankë | 2 | - | 1 | 4 | 7 | - | - | - | 2 | 2 | 2 | - | 1 | 6 | 9 |
| Administrim- Biznesi | - | 1 | 2 | 4 | 7 | - | - | 3 | 3 | 6 | - | 1 | 5 | 7 | 13 |
| Shk. Pol dhe Mardh. Ndërkombëtare | - | - | 3 | 8 | 11 | - | - | 1 | 2 | 3 | - | - | 4 | 10 | 14 |
| Gjithsej | 4 | 2 | 6 | 20 | 32 | - | - | 4 | 7 | 11 | 4 | 2 | 10 | 27 | 43 |

| Universiteti Epoka | | | | | | | | | | | | | | | |
|---------------------------|-------------|-----------------------|------------------------|--------|----------|-------------|-----------------------|------------------------|--------|----------|------------------------|-----------------------|------------------------|--------|----------|
| | Full- time | | | | | Part-time | | | | | Gjithsej staf akademik | | | | |
| | Prof. Dr | Assoc. Prof. Dr | Assist. Prof. Dr | Master | Gjithsej | Prof. Dr | Assoc. Prof. Dr | Assist. Prof. Dr | Master | Gjithsej | Prof. Dr | Assoc. Prof. Dr | Assist. Prof. Dr | Master | Gjithsej |
| | 6 | 4 | 14 | 36 | 60 | 1 | 1 | 5 | 12 | 19 | 7 | 5 | 19 | 48 | 79 |

Për semestrin e vjeshtës 2010-2011, në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë, raporti studentë/pedagogë është 322 studentë/36 pedagogë, pra 8.95, ndërsa në Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Administrative, ky raport është 364 studentë/43 pedagogë, pra 8.47. Për gjithë Universitetin, raporti ne fjalë gjatë semestrit të vjeshtës 2010-2011 është 686 studentë/79 pedagogë, pra 8.68.

- **Lista e stafit akademik për semestrin e pranverës, viti akademik 2010-2011:**

Departamenti i Arkitekturës

| Emri Mbiemri | Titulli akademik | Punesimi |
|-----------------------|------------------|-----------|
| Ahmet Öztaş | Assoc.Prof. Dr | Full-time |
| Halil Semih Eryıldız | Prof. Dr | Full-time |
| Dorina Pojani | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Sokol Dervishi | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Hakan Arslan | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Edmond Manahasa | M.Arch | Full-time |
| Odeta Manahasa | M.Arch | Full-time |
| Artan Hysa | M.Arch | Full-time |
| Desantila Rrumbullaku | M.Arch | Full-time |
| Valbona Koçi | M.Arch | Full-time |
| Anna Yunitsyna | M.Arch | Full-time |
| Egin Zeka | M.Arch | Full-time |
| Lida Miraj | Assist.Prof. Dr | Part-time |
| Ledita Mezini | M.Arch | Part-time |

Departmenti i Inxhinierisë së Ndërtimit

| Emri Mbiemri | Titulli akademik | Punesimi |
|--------------|------------------|-----------|
| Hasan Kaplan | Prof. Dr | Full-time |

| | | |
|--------------------|-----------------|-----------|
| Mehmet Ardiçlioğlu | Assoc.Prof. Dr | Full-time |
| Hüseyin Bilgin | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Yavuz Yardım | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Erion Luga | M.Sc | Full-time |
| Alban Kuriqi | M.Sc | Full-time |
| Rudin Qordja | M.Sc | Full-time |
| Armando Demaj | M.Sc | Full-time |
| Luljeta Bozo | Prof. Dr | Part-time |
| Ylber Muceku | Assist.Prof. Dr | Part-time |
| Ani Duka | M.Sc | Part-time |
| Erjon Petriti | M.Sc | Part-time |

Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike

| Emri Mbiemri | Titulli akademik | Punesimi |
|--------------------------|------------------|-----------|
| Özcan Asilkan | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Şevket Civelek | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Arban Uka | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Vijaya Raju Mullagiri | Assist.Prof | Full-time |
| Ibrahim Meşecan | M.Sc | Full-time |
| Abdurrahman Çelebi | M.Sc | Full-time |
| Ahmed Fatih Ersoy | M.Sc | Full-time |
| Igli Hakrama | M.Sc | Full-time |

| | | |
|-----------------|-----------------|-----------|
| BetimÇiço | Prof. Dr | Part-time |
| Bekim Fetaji | Assoc.Prof. Dr | Part-time |
| Majlinda Fetaji | Assist.Prof. Dr | Part-time |
| Kayhan Ince | Assist.Prof. Dr | Part-time |
| Erind Bedalli | M.Sc | Part-time |
| Orges Çiço | M.Sc | Part-time |

Departmenti i Ekonomiksit

| Emri Mbiemri | Titulli akademik | Punesimi |
|----------------|------------------|-----------|
| Ömer Eroğlu | Prof. Dr | Full-time |
| Cengiz Toraman | Prof. Dr | Full-time |
| Seref Kalayci | Assoc.Prof. Dr | Full-time |
| Nihat Cengiz | M.Sc | Full-time |
| HamzaTok | M.A | Full-time |
| Matilda Likaj | M.A | Full-time |
| Timothy Hagen | M.A | Full-time |

Departmenti i Financë-Bankës

| Emri Mbiemri | Titulli akademik | Punesimi |
|----------------|------------------|-----------|
| Güngör Turan | Prof. Dr | Full-time |
| Sadik Cökelez | Prof. Dr | Full-time |
| Nedret Demirci | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Eglantina Hysa | M.A | Full-time |

| | | |
|-------------------|-----------------|-----------|
| Ermira Zifla | M.A | Full-time |
| Denada Ibrushi | M.A | Full-time |
| Avenir Lleshanaku | M.A | Full-time |
| Shkelqim Cani | Prof. Dr | Part-time |
| Ercument Korkut | Assist.Prof. Dr | Part-time |
| Fatbardha Kadiu | M.A | Part-time |

Departmenti i Administrim Biznesit

| EmriMbiemri | Titulliakademik | Punesimi |
|--------------------|------------------------|-----------------|
| Mustafa Üç | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Huseyin Kanibir | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Murat Karagoz | Assoc.Prof. Dr | Full-time |
| Alba Kruja | M.A | Full-time |
| Urmat Ruskylov | M.A | Full-time |
| Alba Gerdeci | M.A | Full-time |
| Gezim Hysenagolli | M.A | Full-time |
| Ufuk Durna | Assoc.Prof. Dr | Part-time |
| Mirdaim Axhami | Assist.Prof. | Part-time |
| Melih Arat | M.A | Part-time |
| ClirimToci | Assist.Prof. Dr | Part-time |
| Mimoza Kasimati | Assist. Prof. Dr | Part-time |

**Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve
Ndërkombëtare**

| Emri Mbiemri | Titulli akademik | Punesimi |
|------------------|------------------|-----------|
| Cemal Baltacı | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Ferdinand Gjana | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Salih Özcan | Assist.Prof. Dr | Full-time |
| Ramadan Çipuri | M.A | Full-time |
| Niuton Mulleti | M.A | Full-time |
| Albi Kocibelli | M.A | Full-time |
| Xhafer Rakiplari | M.A | Full-time |
| Reina Zenelaj | M.A | Full-time |
| Mustafa Erdem | M.A | Full-time |
| Bekir Çınar | Assist.Prof. Dr | Part-time |
| Bledar Maksuti | Ll.M | Part-time |
| Alban Tartari | M.A | Part-time |
| Gladiola Pazaj | M.A | Full-time |
| Adem Çalışkan | M.A | Part-time |

| Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë | | | | | | | | | | | | | | | |
|--|------------|-----------------|------------------|--------|----------|-----------|-----------------|------------------|--------|----------|------------------------|-----------------|------------------|--------|----------|
| Departamenti | Full- time | | | | | Part-time | | | | | Gjithsej staf akademik | | | | |
| | Prof. Dr | Assoc. Prof. Dr | Assist. Prof. Dr | Master | Gjithsej | Prof. Dr | Assoc. Prof. Dr | Assist. Prof. Dr | Master | Gjithsej | Prof. Dr | Assoc. Prof. Dr | Assist. Prof. Dr | Master | Gjithsej |
| Arkitekturë | 1 | 1 | 3 | 7 | 12 | - | - | 1 | 1 | 2 | 1 | 1 | 4 | 8 | 14 |
| Inxhinieri Ndërtimi | 1 | 1 | 2 | 4 | 8 | 1 | - | 1 | 2 | 4 | 2 | 1 | 3 | 6 | 12 |
| Inxhinieri Kompjuterike | - | - | 3 | 5 | 8 | 1 | 1 | 2 | 2 | 6 | 1 | 1 | 5 | 7 | 14 |
| Gjithsej | 2 | 2 | 8 | 16 | 28 | 2 | 1 | 4 | 5 | 12 | 4 | 3 | 12 | 21 | 40 |

| Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|------------|-----------------|------------------|--------|----------|-----------|-----------------|------------------|--------|----------|------------------------|-----------------|------------------|--------|----------|
| Departamenti | Full- time | | | | | Part-time | | | | | Gjithsej staf akademik | | | | |
| | Prof. Dr | Assoc. Prof. Dr | Assist. Prof. Dr | Master | Gjithsej | Prof. Dr | Assoc. Prof. Dr | Assist. Prof. Dr | Master | Gjithsej | Prof. Dr | Assoc. Prof. Dr | Assist. Prof. Dr | Master | Gjithsej |
| Ekonomiks | 2 | 1 | - | 4 | 7 | - | - | - | - | - | 2 | 1 | - | 4 | 7 |
| Financë-Bankë | 2 | - | 1 | 4 | 7 | 1 | - | 1 | 1 | 3 | 3 | - | 2 | 5 | 10 |
| Administrim-Biznesi | - | 1 | 2 | 4 | 7 | - | 1 | 2 | 2 | 5 | - | 2 | 4 | 6 | 12 |
| Shk. Pol dhe Mardh. Ndërkombëtare | - | - | 3 | 7 | 10 | - | - | 1 | 3 | 4 | - | - | 4 | 10 | 14 |
| Gjithsej | 4 | 2 | 6 | 19 | 31 | 1 | 1 | 4 | 6 | 12 | 5 | 3 | 10 | 25 | 43 |

| Universiteti Epoka | | | | | | | | | | | | | | | |
|---------------------------|------------|-----------------|------------------|--------|----------|-----------|-----------------|------------------|--------|----------|------------------------|-----------------|------------------|--------|----------|
| | Full- time | | | | | Part-time | | | | | Gjithsej staf akademik | | | | |
| | Prof. Dr | Assoc. Prof. Dr | Assist. Prof. Dr | Master | Gjithsej | Prof. Dr | Assoc. Prof. Dr | Assist. Prof. Dr | Master | Gjithsej | Prof. Dr | Assoc. Prof. Dr | Assist. Prof. Dr | Master | Gjithsej |
| | 6 | 4 | 14 | 35 | 59 | 3 | 2 | 8 | 11 | 24 | 9 | 6 | 22 | 46 | 83 |

Për semestrin e pranverës 2010-2011, në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë, raporti studentë/pedagogë është 322 studentë/40 pedagogë, pra 8.05, ndërsa në Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Administrative, ky raport është 364 studentë/43 pedagogë, pra 8.47. Për gjithë Universitetin, raporti në fjalë gjatë semestrit të vjeshtës 2010-2011 është 686 studentë/83 pedagogë, pra 8.27.

- **Dokumenti mbi Performancën e Shkollës, i cili përmban:**

1. *Përqindjen e studentëve kalues në vit dhe përqindjen e atyre që përfundojnë arsimin e lartë¹;*

| UNIVERSITETI EPOKA | VITI I PARË | | | VITI I DYTË | | | VITI TRETË | | | VITI KATËRT | | |
|--|-------------|---------------------------|-------------------------------|-------------|-----------------------------------|-------------------------------|-------------|---------------------------|-------------------------------|----------------|--------------------|--------------------------------------|
| | REGJISTRUAR | KALUAN NE VITIN PASARDHËS | PËRQINDJA E STUDENTËVE KALUES | REGJISTRUAR | KALUAN NE VITIN PASARDHËS PËR DNP | PËRQINDJA E STUDENTËVE KALUES | REGJISTRUAR | KALUAN NE VITIN PASARDHËS | PËRQINDJA E STUDENTËVE KALUES | REGJISTRUAR | U DIPLOMUAN NE DNP | PËRQINDJA E STUDENTËVE QË DIPLOMOHEN |
| FAKULTETI I ARKITEKTURES DHE INXHINIERISE | 79 | 79 | 100% | 95 | 63 | 66% | 59 | 59 | 100% | 19 | 10 | 53% |

¹ Në Universitetin "Epoka", studentët vlerësohen sipas një sistemi të bazuar në notën maksimale të barazvlefshme me 4.00. Në programet Bachelor, në mënyrë që studentët të vijojnë studimet në vitin e tretë, në fund të vitit të dytë (pra semestrit të katërt) duhet të kenë arritur një mesatare të përgjithshme prej më së paku 1.80 nga 4.00, ndërkohë që për t'u diplomuar, duhet të kenë arritur në përfundim të studimeve një mesatare të përgjithshme prej më së paku 2.00 nga 4.00. Në programet Master, në mënyrë që studentët të vijojnë studimet në vitin e dytë, në fund të vitit të parë (pra semestrit të dytë) duhet të kenë arritur një mesatare të përgjithshme prej më së paku 1.80 nga 4.00, ndërkohë që për t'u diplomuar, duhet të kenë arritur në përfundim të studimeve një mesatare të përgjithshme prej më së paku 2.00 nga 4.00.

| | | | | | | | | | | | | |
|---|------------|------------|-------------|------------|------------|------------|------------|------------|-------------|-----------|-----------|------------|
| BA-ARKITEKTURE | 32 | 32 | 100% | 34 | 20 | 59% | 25 | 25 | 100% | - | - | - |
| BA-INXHINIERI NDERTIM | 16 | 16 | 100% | 26 | 19 | 73% | 13 | 13 | 100% | 19 | 10 | 53% |
| BA-INXHINIERI KOMPJUTERIKE | 31 | 31 | 100% | 35 | 24 | 69% | 21 | 21 | 100% | - | - | - |
| FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE DHE ADMINISTRATIVE | 79 | 79 | 100% | 87 | 65 | 75% | 59 | 59 | 100% | 28 | 20 | 71% |
| BA-BANKE FINANCE | 31 | 31 | 100% | 35 | 29 | 83% | 26 | 26 | 100% | 15 | 11 | 73% |
| BA-ADMINISTRIM BIZNES | 17 | 17 | 100% | 20 | 12 | 60% | 13 | 13 | 100% | 13 | 9 | 69% |
| BA-EKONOMIKS | 10 | 10 | 100% | 4 | 4 | 100% | - | - | - | - | - | - |
| BA-SHKENCA POLITIKE DHE MARREDHENIE NDERKOMBETARE | 21 | 21 | 100% | 28 | 20 | 71% | 20 | 20 | 100% | - | - | - |
| TOTALI | 158 | 158 | 100% | 182 | 128 | 70% | 118 | 118 | 100% | 47 | 30 | 64% |

| CIKLI I DYTË | | | | | | |
|---|--------------------|--|--|--------------------|--|---|
| UNIVERSITETI EPOKA | VITI I PARË | | | VITI I DYTË | | |
| | REGJISTRUAR | KALUAN NE VITIN PASARDHËS | PËRQINDJA E STUDENTËVE KALUES | REGJISTRUAR | U DIPLOMUAN NE DND, | PËRQINDJA E STUDENTËVE QË DIPLOMOHEN |
| Fakulteti / Emërtimi i Programit të Studimit | | | | | | |

| | | | | | | |
|---|-----------|-----------|-------------|----------|----------|------------|
| FAKULTETI I ARKITEKTURES DHE INXHINIERISE | 23 | 23 | 100% | 4 | 0 | 0% |
| MSc- INXHINIERI KOMPJUTERIKE | 23 | 23 | 100% | 4 | 0 | 0% |
| FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE DHE ADMINISTRATIVE | 7 | 7 | 100% | 5 | 1 | 20% |
| MA- SHKENCA POLITIKE DHE MARREDHENIE NDERKOMBETARE | 7 | 7 | 100% | 5 | 1 | 20% |
| TOTALI | 30 | 30 | 100% | 9 | 1 | 11% |

| CIKLI I TRETË | | | | | | |
|--|--------------------|--|--|--------------------|--------------------|--|
| UNIVERSITETI EPOKA | VITI I PARË | | | VITI I DYTË | | |
| | REGJISTRUAR | KALUAN NE VITIN PASARDHËS | PËRQINDJA STUDENTËVE KALUES | REGJISTRUAR | U DIPLOMUAN | PËRQINDJA STUDENTËVE DIPLOMOHEN |
| FAKULTETI I ARKITEKTURES DHE INXHINIERISE | 15 | 15 | 100% | 48 | 10 | 21% |

| | | | | | | |
|---|-----------|-----------|-------------|------------|-----------|------------|
| MND- ARKITEKTURE | 4 | 4 | 100% | 7 | - | - |
| MND-INXHINIERI NDERTIMI | 10 | 10 | 100% | 12 | 2 | 17% |
| MND- INXHINIERI KOMPJUTERIKE | 1 | 1 | 100% | 29 | 8 | 28% |
| FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE DHE ADMINISTRATIVE | 43 | 43 | 100% | 116 | 39 | 25% |
| MND - BANKE FINANCE | 8 | 8 | 100% | 14 | - | - |
| MND- ADMINISTRIM BIZNES | 30 | 30 | 100% | 86 | 36 | 31% |
| MND- STUDIME EUROPIANE | - | - | - | 7 | 2 | 29% |
| MND-SHKENCA POLITIKE DHE MARREDHENIE NDERKOMBETARE | 5 | 5 | 100% | 9 | 1 | 7% |
| TOTALI | 58 | 58 | 100% | 164 | 49 | 30% |

2. Përqindjen e të punësuarve që kanë përfunduar këtë program studimi, nëse institucioni reklamon se ky program përgatit për një karrierë apo pozicion të caktuar;

Në përfundim të vitit akademik 2010-2011, studentët e parë janë diplomuar nga programet e studimit të ofruara nga ana e Universitetit dhe për këtë arsye institucioni nuk disponon një informacion të mjaftueshëm mbi numrin e të diplomuarve të punësuar apo që kanë kaluar provimin e shtetit.

3. *Përqindjen e suksesit në provimet e shtetit kur programi i studimit ka lidhje me një profesion të rregulluar, si edhe përqindjen e profesionistëve që kanë përfunduar këtë program studimi dhe janë licencuar.*

Në përfundim të vitit akademik 2010-2011, studentët e parë janë diplomuar nga programet e studimit të ofruara nga ana e Universitetit dhe për këtë arsye institucioni nuk disponon një informacion të mjaftueshëm mbi numrin e të diplomuarve të punësuar apo që kanë kaluar provimin e shtetit.

4. Relacion në lidhje me plotësimin e standardeve shtetërore

1. Përshatshmëria e programeve të studimit me misionin e institucionit;

Siç u përmend edhe më lart, misioni i Universitetit “Epoka” konsiston në të qenit një institucion mësimor-kërkimor inovativ dhe me influencë, në shërbim të vlerave humane thelbësore nëpërmjet prodhimit, shpërndarjes dhe zhvillimit të dijeve në nivel ndërkombëtar; rritja e individëve me ndjeshmëri sociale, të mirëkualifikuar, produktivë, profesionalë dhe të përgjegjshëm, me shpirt të orientuar drejt kërkimit dhe të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare; si dhe dhënia e kontributit në kuadër të përmirësimit të cilësisë së jetës së shoqërisë bazuar në nevojat rajonale dhe botërore.

Në këtë kuadër, të gjitha programet e studimit kanë marrë si bazë për përcaktimin e objektivave të tyre misionin dhe vizionin e Universitetit. Të gjithë programet e studimit të të gjitha niveleve të ofruara nga ana e Universitetit synojnë të përgatisin njerëz të aftë e të kualifikuar që t’i shërbejnë sa më mirë shoqërisë dhe nevojave të saj, jo vetëm në planin kombëtar, por edhe në atë global. Me qëllim mundësimin e integritimit sa më të lehtë të të diplomuarve në tregun e punës, një rëndësi e veçantë i është kushtuar lëndëve aplikative si dhe praktikave të punës, qoftë si pjesë e aktiviteteve kurrikulare, ashtu edhe atyre jashtëkurrikulare.

2. Realizimi i synimeve të programit të studimit nga ana përmbajtësore;

Programet e studimit të Universitetit Epoka janë në përputhje me misionin dhe vizionin e Universitetit. Një nga synimet kryesore të përbashkëta të programeve është përgatitja e intelektualëve të rinj, me dije të mjaftueshme dhe të gatshëm për të kontribuar në përballimin e nevojave të shoqërisë si dhe të aftë në menaxhimin ekonomisë së vendit, nëpërmjet një kurrikule bashkëkohore dhe në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.

Fakti që anglishtja është gjuha e vetme e mësimdhënies ofron mundësinë e përdorimit të literaturës më të përditësuar dhe më të njohur në fushat përkatëse të studimit, si dhe siguron një akses shumë të lehtë të studentëve në burimet elektronike dhe të shtypura të informacionit.

Me qëllim që këta studentë të dalin të mirëpërgatitur dhe të jenë të aftë të përfaqësojnë denjësisht veten dhe Universitetin Epoka, duhet që patjetër të kenë përvetësuar programin mësimor duke u diplomuar vetëm nëse kalojnë në të gjitha lëndët dhe sigurojnë një mesatare të përgjithshme 2.00 nga 4.00, e cila në notë me pikë i korrespondon 70-74, ndërsa sipas sistemit shqiptar i korrespondon notës 7.

3. Realizimi i synimeve të programit të studimit nëpërmjet mbulimit me personelin akademik të përshtatshëm;

Universiteti “Epoka” ka siguruar një staf të mirëkualifikuar për një mësimdhënie cilësore në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.

Kështu në semestrin e vjeshtës 2010-2011 janë angazhuar në procesin mësimdhënës në Universitet 79 pedagogë, prej të cilëve 7 me titullin “Profesor Doktor”, 5 me titullin “Profesor i Asocuar”, 19 me titullin “Asistent Profesor Doktor” dhe 48 me titullin “Master”, ndërkohë që në semestrin e pranverës 2010-2011 janë angazhuar në procesin mësimdhënës në Universitet 83 pedagogë, prej të cilëve 9 me titullin “Profesor Doktor”, 6 me titullin “Profesor i Asocuar”, 22 me titullin “Asistent Profesor Doktor” dhe 46 me titullin “Master”. Në semestrin e vjeshtës 2010-2011, 76% e stafit akademik ishte i punësuar me kohë të plotë, ndërkohë që për semestrin e pranverës 2010-2011, 71% e stafit akademik ishte i punësuar me kohë të plotë.

Fakti që anglishtja është gjuha e vetme e mësimdhënies lehtëson edhe thithjen e stafit të huaj akademik, me tituj dhe grada shkencore, i mirëkualifikuar dhe me përvojë për mësimdhënie sipas kurrikulave bashkëkohore të Universitetit “Epoka. Në semestrin e vjeshtës 2010-2011, 47% e stafit akademik ishte i huaj, ndërkohë që për semestrin e pranverës 2010-2011, 46% e stafit akademik ishte i huaj.

Raporti student/staf akademik në vitin 2010-2011 ka qenë 8-9 studentë/pedagog.

